

BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

SHPLLJE POZICIONI VAKANT

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

Inspektor, Drejtoria e Kontrollit të Terrenit, Zona II (Kategoria III-b).

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”(i ndryshuar); VKB Nr.169 datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr.414, datë 06.01.2023 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë;

Kërkesat e veçanta për për zgjedhjen e kandidatëve :

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së presë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- Diplomë (Bachelor + Master Profesional/Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë, (për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësi nga MAS);
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zotërimi i nje gjuhe te huaj përben avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese,menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

Inspektori ka për detyrë si më poshtë:

- Inspektori varet nga Përgjegjësi i Sektorit në Drejtorinë e Kontrollit të Terrenit dhe ka këto detyra kryesore:
- Realizon kontrollin në territorin e Bashkisë Tiranë në lidhje me situatën ndërtimore.
- Inspekton në mënyrë të vazhdueshme territorin e Njesisë Administrative në të cilin Inspektori është caktuar nga Drejtori i Kontrollit dhe Kryeinspektori.
- Mban Procesverbal të Konstatimit mbi kontrollin e ushtruar në rastet kur konstatohen kundërvajtje administrative, shoqëruar me relacionin përkatës ku parashtrohet gjëndja aktuale në subjekt dhe sugjerimet për masën administrative që do të ndërmerret.
- Regjistron të dhënat për të gjitha subjektet ku konstatohet shkelje administrative dhe ndërtim pa leje (shoqëruar me foto të objekteve në ndërtim si provë e shkeljes administrative);
- Nëshkruan procesverbalet e konstatimit.
- Trajton ankesat e marra nga insitucionet qëndrore, vendore dhe subjektet fizikë e

Dokumentat që aplikanti për Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit të Terrenit, Zona II, duhet të paraqesë janë si më poshtë:

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë (Bachelor + Master Profesional/Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë, dhe listë notash të noterizuara (*për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësi nga MAS*);
4. Çertifikatë personale dhe familjare;
5. Librezë pune origjinale;
6. Dëshmi e gjëndjes mjekësore;
7. Dëshmi penaliteti;
8. 2 fotografi;
9. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi)

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë zyrave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, në adresën : Rr: “Asim Vokshi”, Nd.10, H.4, Ap.3, 1057, Tiranë, afati është deri me datë 29.03.2024 **ora** 14.00.